
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-91027/19 dt. 18.04.2019, të investitorit “Alb Vizion Construction” Sh.P.K. nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesën shumë banesore me afarizëm ndërtesa 3, me etazhitet B+P+8, Lagjja “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 01.07.2021 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Bekim (Hamdi) Ferizi, Afrim (Hamdi) Ferizi dhe Ibrahim Llumnica nga Prishtina, me investitorin “Alb Vizion Construction” Sh.P.K. nga Prishtina me përfaqësues Simon Marku, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-91027/19 dt. 18.04.2019, për përdorimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm, ndërtesa 3, me etazhitet B+P+8, të ndërtuar në kuadër të ngastrës kadastrale nr. 01713-0, Zona Kadastrale Matiçan sipas Vendimit 05 nr.351-36089 dt. 21.02.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-36089 dt. 21.02.2013, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Drejtoria e Inspektionit të Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesave në regjistrat kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pronarët Bekim (Hamdi) Ferizi, Afrim (Hamdi) Ferizi dhe Ibrahim Llumnica nga Prishtina, me investitorin “Alb Vizion Construction” Sh.P.K. nga Prishtina me përfaqësues Simon Marku, më kërkesën me 05 Nr.391/02-91027/19 dt. 18.04.2019, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtesa 3, me etazhitet B+P+8, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Faqe 1 prej 3

Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. “Radovan Zogoviq” nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242

e-mail: urbanizmprishtine@rks-gov.net

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Vendimin nr. 05 nr.351-36089 dt. 21.02.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, ndërtesa 3, me etazhitet B+P+8, të pronarëve Bekim (Hamdi) Ferizi, Afrim (Hamdi) Ferizi dhe Ibrahim Llumica nga Prishtina me investitor "Alb Vizion Construction" Sh.P.K. nga Prishtina me përfaqësues Simon Marku, të ndërtuar në kuadër të ngastrës kadastrale nr. 01713-0, Zona Kadastrale Matiçan, Lagjja "Mati 1" në Prishtinë.
- Aktvendimin numër 05 Nr. 351-35061 dt.10.10.2012, mbi caktimin e taksës Administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Lejen Urbanistike me numër 05 Nr. 350-17249/1 të datës 18.07.2012.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/01-0178233/18 dt. 20.07.2018, Rr. "Met Hasa"
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes,
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë,
- Protokollat e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspektionit-Spektori i Ndërtimit përmes shkresës nr. 09 Nr.356-5338 dt. 20.12.2018 ka arritur në Drejtori: Formulari i Inspektionit Final sipas UA. 05/2017 i plotësuar nga Drejtoria përkatëse, Raporti Final i inspektorëve, njoftim për punët e kryera në objekt si dhe foto të objektit të realizuar.

Objekti i lartë cekur, shtrihet në parcelat 00680-1 dhe 00682-21 ZK Matiçan. Me Kushtet Ndërtimore të lëshuara nga kjo Drejtoria me numër 05 nr.350/02-242212/19 dt. 11.02.2020 është trajtuar edhe parcela 00682-21 andaj me këto kushte i është kërkuar që të ndahet pjesa e sipërfaqes së parcelës e cila është trajtuar me rastin e pajisjes me Leje Ndërtimore për objektin në fjalë. Pas ndarjes së parcelës pala me plotësimin nr. 05nr.391/02-91027/19/01 dt.25.09.2020 ka dorëzua fletat poseduese dhe kopjet e planit pas ndarjes.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektionit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-91027/19 dt. 18.04.2019, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor të miratuar me Vendimin për lejimin e ndërtimit nr. 05 Nr.351-36089 dt. 21.02.2013, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.



Në Raportin e Inspektimit Final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit 05 Nr. 351-36089 të datës 21.02.2013 janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.

Kjo Drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, ndërtesa numër 3, me etazhitet B+P+8, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këto ndërtesa.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-91027/19 DT. 01.07.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prëstreshi

Drejtori:

Ardian Olluri



